



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2267 Prot.

Vlorë, më 02.07.2018

VENDIM

Nr. 23, Datë 27.06.2018

**PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË
PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT
FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE
PËR REGJISTRIMIN E TYRE.**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.06.2018 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM - së 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Delvinë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr.30/1, datë 05.02.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues **Znj. Mahi Zaharo (subjekti Znj. Mahi Zaharo me gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt “banesë vetjake një katëshe” sipërfaqe ndërtimi 70.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200.0 m², me vendndodhje në Lagjen “Lejla Malo” të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 10/37 që kufizohet nga Veriu me pasurinë me nr.10/37, Jugu me rrugë shërbimi dhe pasurinë Nr.10/36 (banesë një katëshe), nga Lindja me rrugë shërbimi nr. pasurie 10/35 dhe nga Perëndimi me pasuri të lirë dhe përrua (pasuria nr.10/37).
2. Të miratojë Vendimin Nr.31/1, datë 05.06.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues **Z. Hamit Huda (subjekti Z. Hamit Huda me gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt “banesë vetjake një katëshe” sipërfaqe ndërtimi 79.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 170.0 m², me vendndodhje në Lagjen “9 Tetori” të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 7/76 që kufizohet nga Veriu me pasurinë me nr.7/76, Jugu me pasurinë Nr.7/76, nga Lindja me pasurinë nr.7/76 dhe nga Perëndimi me pasurinë 7/76.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

3. Të miratojë Vendimin Nr.31/1, datë 04.06.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtëshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues **Znj. Garufala Çupri (trashëgimtarët) (subjekti Znj. Garufala Çupri me gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt “banesë vetjake dy katëshe” sipërfaqe ndërtimi 149.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200.0 m², me vendndodhje në Lagjen “Sinan Ballaci” të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 11/105 që kufizohet nga Veriu me pasurinë me nr.11/270 Rrugë, Jugu me pasurinë Nr.11/105 oborr në përdorim, nga Lindja me pasurie nr.11/108, 11/105 dhe nga Perëndimi me pasuri nr.11/105.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2018

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site : www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 608